

VENDIM
Nr. 320, datë 27.4.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 994, DATË 9.12.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES
SË TOKËS NË PRONËSI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, dhe të neneve 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 6, e vendimit nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë vijon:

“6. Në çdo rast, kur është i nevojshëm hartimi i planvendosjes së ngastrave për regjistrim apo korrigjimi dhe saktësimi i tyre, ato kryhen me shpenzimet e bashkive nëpërmjet topografëve të vet.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama